





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Udhëzues për lëndët e gjykatave të përshtatshme për Ndërmjetësim



Janar, 2020

Ky Udhëzues është mbështetur nga Programi i USAID-it Drejtësia Komerciale

Përmbajtja

1. Hyrje.....	2
2. Qëllimi.....	2
3. Dispozitat ligjore.....	3
4. Zgjidhja e lëndëve në Ndërmjetësim.....	4
4.1 Referimi i lëndëve nga gjykata.....	4
4.2 Referimi i lëndëve nga prokuroria, si dhe	4
4.3 Vet-inicimit nga palët.....	4
5. Kategoria e lëndëve të Ndërmjetësit të Detyrueshëm.....	5
6. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Civile.....	5
7. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta e Punës.....	6
8. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Tregtare.....	6
9. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Administrative.....	7
10. Dokumentacioni i nevojshëm.....	7
11. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Penale.....	7
12. Dokumentacioni i nevojshëm.....	8

1. Hyrje

Një ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen gjykatat e Republikës së Kosovës është numri i madh i lëndëve të pazgjidhura, i cili është në disproporcion me kapacitetin e gjykatave për administrimin e tyre në mënyrë efikase.

Rastet e pazgjidhura në gjykata, janë paraqitur si shqetësim edhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2019. Një ndër rekomandimet kryesore të Komisionit Evropian në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut është rritja e përpjekjeve nga institucionet e vendit për të zvogëluar numrin e rasteve të pazgjidhura në gjykata, edhe përmes përdorimit të metodave alternative për zgjidhjen e kontesteve.

Në këtë drejtim, një ndër metodat më efikase të zgjidhjes alternative të kontesteve e cila mund të përdoret është Ndërmjetësimi.

Procedura e ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës ka filluar të përdoret që në vitin 2008, sipas Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim, i cili është shfuqizuar në shtator të vitit 2018 pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri (Ligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim).

Procedura e ndërmjetësimit është procedurë jashtëgjyqësore e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, rregullat e së cilës janë specifikuar me Ligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim. Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke zbatuar dispozitat përkatëse të këtij ligji, ka hartuar Rregulloren nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, të miratuar me datë 08.05.2019.

Ka shumë arsye në favor të përdorimit të ndërmjetësimit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve, duke filluar nga kostoja më e ulët, shpejtësia e zgjidhjes së rasteve, konfidencialiteti, ruajtja e marrëdhënieve mes palëve si dhe pjesëmarrja më aktive e palëve në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre me vullnet të lirë.

2. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë orientim të përgjithshëm për gjykatat e Republikës së Kosovës lidhur me risitë që ka sjellur Ligji nr. 06/-009 për Ndërmjetësim, në mënyrë që ato të ndihmohen në identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ky udhëzues shërben si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zgjidhur në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

3. Dispozitat Ligjore

Ligji nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, përcakton rregullat e procedurës së ndërmjetësimit në marrëdhëniet kontestuese të subjekteve të së drejtës në raportet juridiko-pasurore, tregtare, familjare, të punës, kontestet nga e drejta pronësore, siç janë të drejtat që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtave pronësore përmes marrëdhënieve kontraktuale apo të fituara përmes trashëgimisë, raporte të tjera civile, procedurat e falimentimit, çështjet administrative dhe çështjet penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë me vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës, prokurorisë apo e ndonjë organi tjetër kompetent.

Ligji parasheh se procedura e ndërmjetësimit mund të përdoret nga palët me vet-inicim, pa inicuar ende çështje në gjykatë, por edhe pas inicimit të çështjes së tyre në gjykatë e në çfarëdo faze të procedurës gjyqësore.

Risia e këtij ligji është se për herë të parë, ka paraparë zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit në kuadër të gjykatave për lëndët e referuara nga gjykatat, si dhe **ndërmjetësimin e detyrueshëm** sipas nenit 9 të Ligjit të ri për Ndërmjetësim - për kategorinë e caktuar të lëndëve. Gjyqtarët, në kuptim të këtij neni, obligohen që këtë kategori të lëndëve t'i referojnë në ndërmjetësim. Nëse çështja e caktuar e inicuar nga palët dështon të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit të detyrueshëm, palët obligohen të dëshmojnë se kanë provuar këtë procedurë por pa sukses, me qëllim që çështja e tyre të vazhdojë të shqyrtohet në procedurë të rregullt gjyqësore.

Rregullorja nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, rregullon procedurën e referimit të lëndëve të gjykatës në ndërmjetësim, administrimin dhe përpunimin e lëndëve të referuara, si dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë procedurë.

Në bazë të ligjit dhe rregullores aktuale, lëndë të përshtatshme për tu refruar në ndërmjetësim konsiderohen të gjitha lëndët civile, të vjetra dhe të reja, me përjashtim të lëndëve të dhunës në familje dhe çështjet për të cilat është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent, sikurse edhe ato që bien ndesh me nenin 3.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës.

Ndërmjetësimi i detyrueshëm zbatohet vetëm për kategorinë e caktuar të llojeve të kontesteve që do të paraqiten në brendinë e tekstit të këtij Udhëzuesi.

Në çështjet penale, ndërmjetësimi mund të zbatohet për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose/dhe me burgim deri në 3 (tri) vjet, duke marrë parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, nivelin e përgjegjësisë penale të tij, me përjashtim të lëndëve të dhunës në familje.

Procedura e ndërmjetësimit për të miturit zhvillohet sipas procedurës së rregulluar me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

4. Zgjidhja e lëndëve në Ndërmjetësim

Përgjithësisht, lëndët që mund të zgjidhen në procedurën e ndërmjetësimit mund të adresohen përmes:

- 4.1 Referimit të lëndëve nga gjykata
- 4.2 Referimit të lëndëve nga prokuroria, si dhe
- 4.3 Vet-inicimit nga palët.

Ky Udhëzues fokusohet në rastet e referimit të lëndëve nga gjykata, të cilat lëndë gjenden aktualisht në gjykatë, si çështje të inicuar nga vet palët. Ndërsa, nuk do të fokusohet në referimin e lëndëve nga Prokuroria dhe në rastet me vet-inicim, për të cilat vlejné rregulla të tjera.

4.1 Referimi i lëndëve nga gjykata

"Ndërmjetësimi është procedurë alternative jashtëgjyqësore, për të zgjidhur mosmarrëveshjen apo kontestin tuaj. Procedura e ndërmjetësimit është e rregulluar me Ligjin për Ndërmjetësim dhe lehtësohet nga një person i paanshëm – ndërmjetësuesi, i cili është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë. Përmes ndërmjetësimit ju mund të vendosni vet për kontestin tuaj brenda afatit prej 90 ditësh me 30 ditë shtesë. Ndërmjetësimi është procedurë plotësisht konfidenciale, ju ruani raportet e mira mes jush, me shpenzime shumë të vogla. Marrëveshja e arritur përmes ndërmjetësimit ka të njëjtin efekt juridik sikurse një vendim përfundimtar i gjykatës, pas aprovimit nga gjykata."

Gjykatat, përkatësisht gjyqtari i çështjes, para se ta referoj një lëndë në ndërmjetësim, vlerëson përshtatshmërinë e saj për ta referuar në procedurë të ndërmjetësimit dhe i sygjeron palëve që të provojnë ndërmjetësimin për zgjidhjen e kontestit mes tyre.

Pas formimit të lëndës në gjykatë, para se ajo t'i ndahet në punë gjyqtarit, gjykata/referenti për pranimin e parashtresave mund t'i udhëzoj palët se kanë mundësi të zgjidhin kontestin e tyre në procedurë të ndërmjetësimit. Nëse pala pajtohet me këtë propozim atëherë njoftohet referenti për ndërmjetësim, i cili kontakton të gjitha palët për të marrë pajtimin e të gjithëve për të provuar procedurën e ndërmjetësimit. Nëse të gjithë pajtohen atëherë procedura e ndërmjetësimit vazhdon të zhvillohet sipas dispozitave të rregullores përkatëse.

Nëse palët kanë sukses të zgjidhin kontestin mes tyre në këtë procedurë, njoftohet një gjykatës i gjykatës përkatëse, ku është formuar lënda, për aprovimin e marrëveshjes së arritur në mes palëve. Edhe në rast të dështimit të ndërmjetësimit, e njëjta lëndë dërgohet te një gjyqtar kompetent, për të vazhduar shqyrtimin e çështjes konkrete në procedurë të rregullt gjyqësore.

Çështjet penale, gjyqtari mund t'i referoj në ndërmjetësim, në çdo fazë të procedurës, pasi ta ketë marrë pëlqimin e palës së dëmtuar dhe të pandehurit.

5. Kategoria e lëndëve të Ndërmjetësimit të Detyrueshëm

Ndërmjetësimi i detyrueshëm është koncept i ri i paraparë me Ligjin e ri për Ndërmjetësim. Llojet e kontesteve për të cilat duhet të zbatohet ndërmjetësimi i detyrueshëm sipas nenit 9 të këtij ligji janë:

- kontestet nga marrëdhëniet familjare që kanë të bëjnë me alimentacion,
- kujdestaria e fëmijëve,
- kontaktet dhe mbajtja e fëmijës,
- ndarja e pronës së përbashkët martesore,
- kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve dhe
- kompensimi i pronës së shpronësuar

6. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Civile

Përveç kontesteve të cilat janë paraparë me Ligjin për Ndërmjetësim, ka edhe konteste të tjera të natyrës civile të cilat mund të referohen në procedurën e ndërmjetësimit nga ana e gjyqtarëve sipas vlerësimit të tyre dhe pajtimit të palëve. Disa nga lëndët civile të cilat *mund të referohen* por që nuk kufizohen, për zgjidhje përmes ndërmjetësimit janë:

- Kontestet lidhur me fitimin dhe humbjen e të drejtës së pronësisë në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme
- Kontestet lidhur me mosrespektimin e të drejtës së parablerjes
- Kontestet lidhur me bashkëpronësinë
- Kontestet lidhur me pronësinë e përbashkët
- Kontestet lidhur me Posedimin dhe bashkëposedimin
- Kontestet lidhur me pengim posedimin
- Kontestet lidhur me marrëdhëniet juridike reciproke të pronarëve të njëjësive të ndërtesës
- Kontestet lidhur me të drejtën fqinjësore, si: Detyrimi për përkujdesje, Ngatërrimi i kufirit, Shënimi dhe instalimet e kufirit, Pema në kufi, Imisione, Frutat, Degët dhe rrënjët, Hyrja e domosdoshme për marrjen e kafshëve, Kalimi i domosdoshëm, E drejta e kalimit për ndërtesa, Shfrytëzimi i përkohshëm i një paluajtshmërie fqinje, Shembja e një ndërtese, Ndërtimi përtej vijës së kufirit, Mihja rrezikuese, Rrjedha e ujit.
- Kontestet lidhur me mbrojtjen e pronësisë, si: Kërkesa e pronarit për kthimin e sendit nga poseduesi pa të drejtë posedimi, Kërkesa e pronarit kundër poseduesit me mirëbesim, Kërkesat e poseduesit me mirëbesim nga pronari, Kërkesat e pronarit kundër poseduesit me keqbesim, Kërkesat e poseduesit me keqbesim nga pronari, Kërkesa për largimin dhe mos-përsëritjen e cënimit të pronësisë dhe farëdo cënimi të posedimit apo përdorimit të së drejtës së pronësisë mbi një send
- Kontestet lidhur me servitutet

- Kontestet lidhur me barrën sendore
- Kontestet lidhur me të drejtën e ndërimit
- Kontestet lidhur me mospërbushjen ose përbushjen e pjeshme të kontratave
- Kontestet lidhur me kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial
- Kontestet lidhur me shpërblimi në formë të rentës në të holla
- Kontestet nga e drejta e banimit
- Kontestet lidhur me administrimin e pasurisë së fëmijës nga njëri prind, të cilit i është besuar rritja dhe edukimi i fëmijës
- Kontestet lidhur me pasojat personale e pasurore ndërmjet bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës
- si dhe konteste të tjera që vlerësohen të përshtatshme për ndërmjetësim.

7. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta e Punës

Kontestet nga marrëdhënia e punës mund të referohen në procedurën e ndërmjetësimit sipas vlerësimit të gjykatës dhe pajtimit të palëve në kontest. Disa nga lëndët nga marrëdhënia e punës të cilat *mund të referohen*, por që nuk kufizohen, për zgjidhje përmes ndërmjetësimit janë:

- kontestet lidhur me diskriminimin në punë mbi çfarëdo baze dhe mobingun
- kontestet lidhur me kompenzimin e pagave
- kontestet lidhur me kompenzimin e përfitimeve dhe shpërblimeve tjera në punë mbi bazën e trajtimit të barabartë të të punësuarve
- kontestet lidhur me kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial për lëndimet në punë, përfshirë fitim e humbur dhe rentën
- si dhe konteste të tjera që vlerësohen të përshtatshme për ndërmjetësim.

8. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Tregtare

Kontestet tregtare mund të referohen në procedurën e ndërmjetësimit sipas vlerësimit të gjykatës dhe me pajtimin e palëve në kontest.

Disa nga kontestet tregtare të cilat *mund të referohen*, por që nuk kufizohen, për zgjidhje përmes ndërmjetësimit janë:

- Kontestet e shkaktuara nga konkurrenca e ndershme ose e pandershme
- Kontestet lidhur me mospërbushjen e kontratave tregtare të lidhura mes personave fizikë dhe juridik (me përjashtim të kontratave publike)
- Kontestet që rrjedhin nga funksionimi dhe mbarëvajtja e shoqërive tregtare. Në këtë kategori përfshihen të gjitha mosmarrëveshjet e krijuara për shkak të vendimmarrjeve në organet drejtuese të tyre, apo ato që vijnë për shkak të marrëdhënieve të ortakëve/aksionerëve

- Kontestet lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial
- Kontestet lidhur me kontratat e sigurimeve
- Kontestet që rrjedhin nga kontratat e kredisë (riprogramimi, kamata e kundërligjshme, garancionet bankare)
- Kontestet lidhur me markat tregtare
- si dhe konteste të tjera nga e drejta tregtare që kualifikohen si të përshtatshme për ndërmjetësim.

9. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Administrative

Çështjet nga e drejta administrative mund të referohen në procedurën e ndërmjetësimit sipas vlerësimit të gjykatës dhe me pajtimin e palëve. Kategoria e lëndëve/konflikteve administrative të cilat *mund të referohen*, por që nuk kufizohen, për zgjidhje përmes ndërmjetësimit janë:

- Rastet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e aktit administrativ ose afateve për kryerjen e obligimeve individuale.
- Çështjet që kanë të bëjnë me kërkesëpaditë të cilat janë paraqitur së bashku me kërkesëpadinë kryesore si kërkesa aksesore për kthimin e sendeve të marra ose kompensimin e dëmit.
- Kontestet lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit, heqjen dorë nga kompensimi i dëmit, afatet për kthimin e sendeve, heqjen dorë nga kthimi i sendeve, etj.
- si dhe raste tjera administrative që vlerësohen të përshtatshme për ndërmjetësim.

10. Dokumentacioni i Nevojshëm

Dokumentacioni përcjellës i nevojshëm, të cilin duhet ta përmbajë lënda që referohet në procedurën e ndërmjetësimit, për kategoritë e lartpërmendura por që nuk kufizohet, është si në vijim:

- Padia (kopje);
- Vendimi i gjyqtarit për referimin e rastit në ndërmjetësim;
- Kur rasti përcjellët në ndërmjetësim nga referenti i gjykatës për pranimin e parashtresave, referenti për ndërmjetësim sigurohet të merr pëlqimin e palëve për ndërmjetësim.
- Përgjigjja në padi (kopje) nëse ka ose procesverbali i seancës në të cilin palët janë pajtuar që rasti i tyre të referohet për zgjidhje përmes Ndërmjetësimit, si dhe dokumentacion tjetër që duhet për nevojat e lëndës.

11. Lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim nga e Drejta Penale

Në fushën penale, për veprat penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet (*përfshijtur rastet e Dhunës në Familje*), të cilat pas ngritjes së aktakuzës sipas vlerësimit të

gjqtarit, me propozimin e prokurorit ose me propozimin/pajtimin e të dëmtuarit dhe të pandehurit që çështjen e tyre ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit, lëndën e tillë e referon në ndërmjetësim.

Veprat penale të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës që konsiderohen të përshtatshme për tu referuar në ndërmjetësim janë:

- Kanosja, neni 181 par.1 dhe 2 i KPRK
- Ngacmimi, neni 182 par.1
- Sulmi, neni 184 par.1
- Lëndim i lehtë trupor, neni 185 par.1
- Pjesëmarrja në rrahje, neni 187
- Shtrëngim, neni 192 par.1
- Cënimi i të drejtës në grevë, neni 221
- Keqpërdorimi i të drejtës në grevë, neni 222
- Vjedhja e shërbimeve, neni 314
- Shpërdorimi i pasurisë së huaj, neni 318
- Marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, neni 319
- Vjedhja e pyllit, neni 349
- Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike, neni 357 par. 2
- Mos evitimi i rrezikut, neni 362
- Rrezikimi i trafikut publik, neni 370 par.1
- Mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm, neni 405
- Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, neni 406
- Marrja apo asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare, neni 407
- Vetëgjyqësia, neni 410 par.1
- si dhe vepra penale të tjera që vlerësohen të përshtatshme për ndërmjetësim.

12. Dokumentacioni i Nevojshëm

Dokumentacioni përcjellës i nevojshëm, të cilin duhet ta përmbajë lënda penale që referohet në procedurën e ndërmjetësimit, por që nuk kufizohet, është si në vijim:

1. Vendimi i gjyqtarit për referimin e rastit në ndërmjetësim,
2. Aktakuza (kopje),
3. Procesverbali i shqyrtimit në të cilin palët janë pajtuar për zgjidhjen e rastit në ndërmjetësim.
4. Si dhe dokumentacion tjetër që duhet për nevojat e lëndës.

Shënim:

Formularët për procedurën e ndërmjetësimit, gjenden në aneksin e Rregullores nr. 04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, e miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 08.05.2019.

Ky Udhëzues, vlen për të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Ky Udhëzues, hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KGJK.



Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë,

Datë: 29.01.2020